



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:098067  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05517799

Ac.nr.128/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësve V.I. dhe G.B. që të dy nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B.H., avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kompania e Avokatëve “...” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.328/19, të datës 11.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.328/19 i datës 11.11.2019, në pikën I dhe III, VËRTETOHET.

Pika II e dispozitivit të aktgjykimit mbetet e pashqyrtuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.328/19, të datës 11.11.2019, ka vendosur si në vijim: I.PJESËRISHT MIRATOHET kërkesëpadia e paditësve V.I. dhe G.B. që të dy nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” – Sh.A - Prishtinë, që paditësit të parë V.I. nga Gjakova në emër të kompensimit të dëmit jo material t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1.400.00€, (njëmijë e katërqind euro), paditëses së dytë G.B. nga Gjakova në emër të kompensimit të dëmit jo material t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2.800.00 € (dymijë e tetëqind euro), me kamatën përkatëse ligjore 8% në vit, e cila fillon të

rrjedhë nga dt.03.05.2019 e tutje, e deri në pagimin definitiv, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë dhe atë për këto kritere të dëmit:

Për paditësin e parë V.I. nga Gjakova:

- për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 800,00 €
- për frikën e përjetuar shumë prej 600,00 €

Për paditësen e dytë G.B. nga Gjakova:

- për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 1.300,00 €
- për frikën e përjetuar shumë prej 900,00 €
- për shëmtim – zvogëlimin e estetikës shumë prej 500,00 €,
- në emër të përkujdesit dhe ndihmës së huaj shumë prej 50.00 €,
- në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 50.00€.

II. KËRKESË-PADIA e paditësve V.I. dhe G.B. që të dy nga Gjakova, me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S....” – Sh.A - Prishtinë, që t’ia paguaj edhe pjesën tjetër të mbetur për paditësin e parë në lartësinë e përgjithshme prej 600,00€ (gjashëqind euro), paditëses së dytë G.B., për pjesën tjetër të mbetur në lartësinë e përgjithshme prej 2.000,00 € (dymijë euro), me kamatën e lartë cituar REFUZOHET në tërësi si e pathemeltë dhe atë për këto kritere të dëmit: Për paditësin e parë Vehbi Istrefi nga Gjakova: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 200,00 €; për frikën e përjetuar shumë prej 400,00 € Për paditësen e dytë G.B. nga Gjakova: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 200,00 €; për frikën e përjetuar shumë prej 600,00 €; për shëmtim – zvogëlimin e estetikës shumë prej 500,00 €, në emër të përkujdesit dhe ndihmës së huaj shumë prej 150.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 50.00 €; në emër të shpenzimeve mjekësore shumë e përgjithshme prej 500.00 €.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” – Sh.A - Prishtinë, që në emër të shpenzimeve procedurale paditësve V.I. dhe G.B. që të dy nga Gjakova t’iu paguaj shumë e përgjithshme prej 875.20 € (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë euro e njëzet cent), në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, kurse pjesa tjetër përtej shumë së aprovuar refuzohet si e pabazuar, pasi shpenzimet janë llogaritur në bazë të suksesit në procedurë.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, të prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që lëndën ta kthej në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 03.05.2019, paditësit në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, në lartësinë e precizuar si në parashtrësën e datës 25.10.2018, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.328/19 të datës 11.11.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, me arsyetimin se nuk ishte kontestues baza juridike e kërkesëpadisë, përderisa e paditura ka propozuar edhe zgjidhjen e kontestit me marrëveshje, gjersa nga provat materiale të administruara gjykata ka konstatuar se aksidenti në të cilin paditësit kanë marrë lëndime trupore, është shkaktuar me lëshimet e drejtuesit të automjetit ....., me targa të regjistrimit....., me policë valide të sigurimit te e paditura. Rrjedhimisht, përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga i siguruari i tij konfirmohet nga ekspertiza e komunikacionit e dt 08.12.2018, e ekspertit B.P. si dhe nga aktgjykimi penal i gjykatës themelore në Gjakovë P.nr....., dt. 15.02.2019. me të cilin drejtuesi i automjetit të siguar te e paditura është shpallur fajtor për shkaktimin e aksidentit.

Duke qenë se kontestues është paraqitur lartësia e kërkesëpadisë, nga kjo arsye gjykata sipas propozimit të paditësve dhe për vërtetimin e lartësisë së dëmit, si provë ka nxjerrë ekspertizën mjekësore të hartuar nga Dr. Burim Sahatqija – ortoped dhe Dr. Agron Zajmi – neuropsikiatër. Për paditësin V.I. eksperti ortoped ka deklaruar se i njëjti ka pësuar lëndime të lehta trupore. Ka shtuar se paditësi nuk ka pasur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë dhe as të intensitetit të rëndë, ndërkaq ka përjetuar dhimbje të intensitetit të mesëm 7 ditë, dhimbje të intensitetit të ulët 14 ditë. nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përhershëm jetësor, shëmtim trupor nuk ka, përkujdesja dhe ndihma e personit të tretë nuk i është nevojitur. Sipas ekspertit psikiatër paditësi ka pësuar frikë primare dhe sekondare të intensitetit jashtëzakonisht të lartë në kohëzgjatje prej disa sekonda para dhe pas aksidentit. Intensitetit i mesëm ka zgjatur 15 ditë pas aksidentit. Frika e intensitetit të ulët ka zgjatur një muaj pas aksidentit duke u shpreh me shqetësime neurotike gjatë pjesëmarrjes në komunikacion si dhe zhurmave të cilat prodhohen në natyrë - komunikacion.

Për paditësen G.B. eksperti ortoped/traumatolog ka konstatuar se e njëjta ka pësuar lëndime të natyrës së rëndë trupore, pa pasoja. Dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë – nuk ka pasur. Dhimbje e intensitetit të rëndë – 5 min. Dhimbje e intensitetit të mesëm – 24 orë. Dhimbje të intensitetit të ultë – 14 ditë. Aktivitet i përhershëm jetësor nuk i është zvogëluar. Eksperti ka konstatuar se te paditësja si pasojë e aksidentit ka shëmtim trupor i shkallës së ulët nën 10% të sipërfaqes trupore që karakterizohet me 5% të estetikës. Është konstatuar se paditësja ka pasur nevojë për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë si dhe për ushqim të përforcuar në 24 orët e para pas aksidentit ndërsa terapia fizikale i është nevojitur 10 ditë në vit. Sa i përket frikës së përjetuar si pasojë e aksidentit, eksperti ka konstatuar se paditësja ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë, në kohëzgjatje disa sekonda. Frika me intensitet të mesëm ka zgjatur edhe një muaj pas aksidentit, ndërsa frikë të intensitetit të ultë ka përjetuar në kohëzgjatje prej tre muaj pas aksidentit.

Gjykata duke vlerësuar natyrën e lëndimeve të paditësve gjykoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se shumat janë proporcionale me dëmin e pësuar dhe me qëllimin ligjor për të cilin parashihet kompensimi, duke shtuar se aprovimi i shumave më të larta nuk do t'i shërbente qëllimit ligjor për kompensim të dëmit. Sa i përket kërkesës së paditëses G. B., lidhur me shpenzimet mjekësore, gjykata parashtror se ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë nga fakti se paditësja nuk ka argumentuar me asnjë provë materiale shpenzimet e kërkuara dhe se ato

pretendime sa i përket këtij kriteri të dëmit material mbetën vetëm pretendime deklarative, të pa argumentuara në asnjë mënyrë dhe si të këtilla, pa ndikim për vendosje ndryshe të çështjes.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë, i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Pra, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Të pabazuara qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë dhe lartësisë së saj, nga gjykata e shkallës së parë janë provuar mbi bazën e ekspertizave profesionale lidhur me aksidentin në komunikacion dhe shkaktarin e aksidentit si dhe mbi bazën e ekspertizave mjekësore lidhur me natyrën dhe pasojat e lëndimeve të pësuar nga paditësit në atë aksident. Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, gjykata ka ardhur në përfundim se ekziston detyrimi ligjor i të paditurës që paditësve t'ia kompensoj dëmin jomaterial në shumat e gjukuara si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Ndonëse aktgjykimi nuk ka referencë në të drejtën materiale, megjithëkëtë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, mospërfshira e dispozitave të ligjit material nuk e bën e bën aktgjykimin e paekzaminueshëm dhe as të paqëndrueshëm, përderisa faktet vendimtare dhe me ndikim për vendosjen si në dispozitiv rezulton se janë shqyrtuar me kujdes nga gjykata e shkallës së parë. Kështu, duke marrë parasysh se nuk ishte kontestues baza juridike e kërkesëpadisë, meqë aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me lëshimet e ngasësit të automjetit të siguruar te e paditura, prandaj në kuptim të nenit 3 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia lidhur me nenin 179 dhe 183 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, ekziston detyrimi juridik i të paditurës që paditësve t'ia kompensoj dëmin për shkak të lëndimeve që kanë marrë nga aksidenti në fjalë.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial dhe atë për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar dhe shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë duke siguruar që kompensimi të shërbej si satisfakcion për paditësit. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial, sepse vendimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor të cilët kanë konstatuar se paditësit kanë përjetuar dhimbje fizike dhe frikë (në formën dhe kohëzgjatjen të konstatuar si në ekspertizë). Sipas ekspertizave mjekësore rezulton se paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe për ushqim të përforcuar dhe që e njëjta nga aksidenti ka shëmtim trupor në shkallë të ulët, e që gjykata e çështjes për secilën kategori të dëmit ka caktuar shpërblimin e dëmit në raport me

shkallën e shkëljes së të mirës, duke gjykuar kompensim në shumën të cilën e ka vlerësuar se është në harmoni edhe me praktikën e mirë gjyqësore.

Pretendimin ankimor se gjykata e shkallës së parë në vendimin për shpenzimet procedurale nuk ka marrë për bazë suksesin në procedurë, gjykata ankimore e vlerësoi si të pabazuar meqë gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë ndërsa shpenzimet e pranuar në aktgjykim kanë qenë të domosdoshme që gjykata e shkallës së parë të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Meqenëse ndaj pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, të vendosur s në pikën II të aktgjykimit, paditësit nuk kanë paraqitur ankesë, prandaj aktgjykimi në këtë pjesë nuk është shqyrtuar.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.128/20, me datë 21.03.2024

Kryetare e kolegjit  
Hunaida Pasuli